

**Esmeralda Keshi (Cami)** është anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve si përfaqësuese e Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë. Ajo është diplomuar për Drejtësi pranë Universitetit të Tiranës dhe si Prokurore pranë Shkollës së Magjistraturës. Funkcionin e saj si prokurore e ka ushtruar në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës dhe Dibër. Mandati i saj në detyrën e anëtares së Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i vlefshëm deri në dhjetor 2023.